

**Rregullore e Promocionit “Fanta Halloween” të organizuar nga
Coca-Cola Bottling Shqipëria (CCBS)**

1. Subjekti organizues i promocionit **“Loja Promocionale Fanta Halloween”** është shoqëria Coca-Cola Bottling Shqipëria Shpk (CCBS), NUIS J61901061H, me seli në adresën: Rr. Kombëtare Tiranë-Durrës, Km 5, Kashar, Tiranë.
2. Promocioni **“Loja Promocionale Fanta Halloween”** do të zhvillohet në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.
3. Në promocionin **“Loja Promocionale Fanta Halloween”** mund të marrin pjesë të gjithë personat fizikë me rezidencë të përhershme në Republikën e Shqipërisë, mbi 18 Vjeç, të cilët do të blejnë produktet Fanta në paketimet: Fanta Orange kanaçe 150ml, Fanta Exotic kanaçe 150ml, Fanta Lemon kanaçe 150ml, Fanta Orange qelq 250ml, Fanta Exotic qelq 250ml, Fanta Orange kanaçe 330ml, Fanta Exotic kanaçe 330ml, Fanta Lemon kanaçe 330ml, Fanta Orange Zero kanaçe 330ml, Fanta Crimson Cherry kanaçe 330ml, Fanta Orange shishe PET 450ml, Fanta Exotic shishe PET 450ml, Fanta Lemon shishe PET 450ml, Fanta Crimson Cherry shishe PET 450ml, Fanta Orange shishe PET 900ml, Fanta Exotic shishe PET 900ml, Fanta Lemon shishe PET 900ml, Fanta Crimson Cherry shishe PET 900ml, Fanta Orange PET 1.5L, Fanta Exotic PET 1.5L, Fanta Lemon PET 1.5L, Fanta Orange Zero 1.5L, Fanta Orange PET 2L, Fanta Exotic PET 2L përgjatë periudhës së promocionit 28 Shtator 2026 - 12 Tetor 2026. Produktet e sipërpërmendura duhet të jenë të prodhuara nga/për Coca-Cola Bottling Shqipëria shpk.
4. Produktet e CCBS të përfshira në këtë promocion do të shiten me çmimin normal të tregut. Çmimi i rekomanduar i tregut për këto produkte gjendet në tabelën më poshtë:

Emërtimi	Formati	Çmimi i Rekomanduar (Pa TVSH)	Çmimi i Rekomanduar (Me TVSH)
Fanta Lemon	0.15L	ALL 37.50	ALL 45.00
Fanta Exotic	0.15L	ALL 37.50	ALL 45.00
Fanta Orange	0.15L	ALL 37.50	ALL 45.00
Fanta Exotic	0.25L	ALL 108.30	ALL 130.00
Fanta Orange	0.25L	ALL 108.30	ALL 130.00
Fanta Orange	0.33L	ALL 66.60	ALL 80.00
Fanta Orange Zero	0.33L	ALL 66.60	ALL 80.00
Fanta Lemon	0.33L	ALL 66.60	ALL 80.00
Fanta Exotic	0.33L	ALL 66.60	ALL 80.00
Fanta Crimson Cherry	0.33L	ALL 66.60	ALL 80.00
Fanta Orange	0.45L	ALL 66.60	ALL 80.00
Fanta Exotic	0.45L	ALL 66.60	ALL 80.00
Fanta Lemon	0.45L	ALL 66.60	ALL 80.00
Fanta Crimson Cherry	0.45L	ALL 66.60	ALL 80.00
Fanta Orange	0.5L	ALL 75.00	ALL 90.00

Fanta Exotic	0.5L	ALL 75.00	ALL 90.00
Fanta Orange	0.9L	ALL 83.30	ALL 100.00
Fanta Exotic	0.9L	ALL 83.30	ALL 100.00
Fanta Crimson Cherry	0.9L	ALL 83.30	ALL 100.00
Fanta Orange	1.5L	ALL 133.30	ALL 160.00
Fanta Exotic	1.5L	ALL 133.30	ALL 160.00
Fanta Lemon	1.5L	ALL 133.30	ALL 160.00
Fanta Orange Zero	1.5L	ALL 133.30	ALL 160.00
Fanta Exotic	2L	ALL 158.30	ALL 190.00
Fanta Orange	2L	ALL 158.30	ALL 190.00

Për të marrë pjesë në promovion konsumatorët duhet të blejnë një nga produktet e sipërpërmendura, të skanojnë QR në paketim dhe të aksesojnë në aplikacionin “Coca-Cola Play & Win Prizes” dhe të krijojnë një llogari me të dhënat e tyre, pa kosto. Më pas konsumatori duhet të regjistrohet me të dhënat personale duke hyrë tek paneli kryesor ku duhet të ngarkojë faturën fiskale nëse dëshiron të bëhet pjesë e këtij shorteu. Një konsumator ka të drejtë të marrë pjesë më shumë se një herë.

Shoqëria e cila do të menaxhojë, monitorojë website dhe ku do të bëhet përzgjedhja rastësore e fituesit për këtë promovion është Agjensia IUP LABS me seli në adresën: Rr.Themistokli Gërmenji, Nr.1, 1001, Tiranë, Shqipëri.

Mekanizmi i promovionit “**Loja Promocionale Fanta Halloween**” konsiston në një kombinim të formulave “Bëj blerje të një produkti Fanta në paketimet Fanta Orange kanaçe 150ml, Fanta Exotic kanaçe 150ml, Fanta Lemon kanaçe 150ml, Fanta Orange qelq 250ml, Fanta Exotic qelq 250ml, Fanta Orange kanaçe 330ml, Fanta Exotic kanaçe 330ml, Fanta Lemon kanaçe 330ml, Fanta Orange Zero kanaçe 330ml, Fanta Crimson Cherry kanaçe 330ml, Fanta Orange shishe PET 450ml, Fanta Exotic shishe PET 450ml, Fanta Lemon shishe PET 450ml, Fanta Crimson Cherry shishe PET 450ml, Fanta Orange shishe PET 900ml, Fanta Exotic shishe PET 900ml, Fanta Crimson Cherry shishe PET 900ml, Fanta Orange PET 1.5L, Fanta Exotic PET 1.5L, Fanta Lemon PET 1.5L, Fanta Orange Zero 1.5L, Fanta Orange PET 2L, Fanta Exotic PET 2L dhe apliko për t’u bërë pjesë e shorteut “**Loja Promocionale Fanta Halloween**” për të fituar paketën udhëtim çift në Transilvani, Rumani (kështjella e Drakulas).

Për të marrë pjesë në promovionin “**Loja Promocionale Fanta Halloween**” dhe për të fituar paketën çift të vendosur në dispozicion nga CCBS, pjesëmarrësit duhet të ndjekin udhëzimet vijuese të përcaktuara në këtë rregullore:

- Konsumatori duhet të jetë mbi 18 vjeç.
- Konsumatori duhet të blejë një nga produktet Fanta në paketimet e sipërcituara, pjesë e kësaj Loje promocionale.
- Konsumatori duhet të hyjë në aplikacionin Coca-Cola Play & Win Prizes dhe të krijojë një llogari.
- Konsumatori duhet të plotësojë të dhënat e kërkuara në aplikacionin Coca-Cola Play & Win Prizes dhe të ngarkojë faturën fiskale ku të lexohet blerja e minimalisht një produkti Fanta në paketimet e sipërcituara, dhe të perfundojë regjistrimin.
- Loja promocionale do të jetë e vlefshme: Nga data 28 Shtator 2026 – 31 Tetor 2026.
- Hedhja e shorteut për përzgjedhjen e fituesit do të bëhet me datë 15 Tetor 2026 në praninë e një noteri publik ose të As/Noterit të autorizuar nga CCBS.
- Data dhe orari i hedhjes së shorteut do të jetë:
 - **15 Tetor 2026 ora 10:00**
- Fituesi do të zgjidhet në mënyrë rastësore. Noteri do të çertifikojë me anë të një procesverbali, i cili do të mbahet në momentin e hedhjes së shorteut dhe përzgjedhjes së fituesit.
Ky procesverbal do të firmoset nga personat e pranishëm të cilët do të jenë; një punonjës i autorizuar nga CCBS, një punonjës i autorizuar nga Agjensia IUP LABS, një punonjës i autorizuar nga Autoriteti Mbikqyrës i Lojrave të Fatit, një inspektor i autorizuar nga Drejtoria e Tatimeve si dhe Noteri Publik dhe/ose As/Noterit të autorizuar nga CCBS.
- Ditët e pushimit do të zëvendësohen nga dita parardhëse ose pasardhëse.

- Vendi ku do të hidhet shorteu për zgjedhjen e fituesit do të jetë pranë Agjensisë IUP LABS me **adresë: Rr.Themistokli Germenji, Nr1, Tiranë, 1001, Shqipëri**. Mënyra e përzgjedhjes së fituesit do të jetë rastësore nga sistemi. Do të përzgjidhet në mënyrë rastësore 1 fitues. Fitues i shorteut do të konsiderohet personi i parë, numrat e tjerë do të mbahen rezervë.

Gjatë kohëzgjatjes së këtij promovioni, konsumatori do të ketë mundësinë të fitojë në total:

- 1 paketë udhëtimi çift në Transilvani, Rumani, kështjella e Drakulës.
- Vlera totale e paketës së udhëtimit është si më poshtë:

Përshkrim	Sasi (copë)	Dhurata e lojës promovionale	
		Cmim/njësi në Lekë, pa TVSH	Vlera totale e dhuratave në Lekë me TVSH
Paketë udhëtimi çift për në Transilvani, në kështjellën e Drakula (data: 31 Tetor 2026 - 02 Nëntor 2026)	1 paketë udhëtimi çift	59,931.67 ALL	71,918.00 ALL

- *Paketa e udhëtimit **nuk** është konvertueshme në para.
- *Çmimi i paketës së udhëtimit është referencë.

Numri i parashikuar i pjesëmarrësve në promovionin “Loja Promocionale Fanta Halloween” është rreth ~1 milion.

E përfshirë në paketë është: udhëtimi me avion, çanta shpine, transfertat aeroport – hotel – aeroport, akomodimi 2 netë në single rooms, tur në kështjellën e Drakula me datë 01 Nëntor 2026 - 12 orë.

Për të tërhequr dhuratën e tij, fituesi duhet të dërgojë me postë elektronike të dhënat personale, si: *emër, mbiemër, atësi, numri i kartës së identitetit* brenda 48 orëve pune.

Tërheqja e dhuratës do të bëhet në ambjentet e zyrave të administratës Coca-Cola Bottling Shqipëria.

Gjithashtu, në përputhje me Ligjin **Nr. 124/2024** “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” dhe Udhezimeve përkatëse, pasi një pjesëmarrës njoftohet me postë elektronike (e-mail) se është shpallur fitues i Promocionit, atij do t’i dërgohet një link elektronik përmes të cilit duhet të konfirmojë pranimin ose refuzimin e përpunimit të të dhënave të tij personale për qëllimet e administrimit të Promocionit, dorëzimit të biletave dhuratë dhe nëse është e nevojshme sipas kësaj Rregulloreje, publikimit të emrit dhe/ose të dhënave të tjera identifikuese në faqen zyrtare të web: www.ccbs.al, të cilat do të shkatërrohen brenda 14 ditëve nga përfundimi i dorëzimit të dhuratës, sipas ligjit në fuqi **Nr. 124/2024**.

Në rast se fituesi refuzon të japë pëlqimin për përpunimin e të dhënave personale që janë të nevojshme për administrimin e Promocionit dhe dorëzimin e biletave dhuratë, ai do të konsiderohet se ka hequr dorë vullnetarisht nga e drejta për t’u shpallur fitues dhe për të përfutur dhuratën.

Në këtë rast, fituesi humbet çdo të drejtë ankimimi ndaj Coca-Cola Bottling Shqipëria Sh.p.k. (CCBS), NV Coca-Cola Services SA (CCS) dhe çdo pale të autorizuar që administron Promocionin lidhur me biletat dhuratë.

Në rast të humbjes së statusit të fituesit sipas përcaktimeve të mësipërme, CCBS ka të drejtë të shpallë fitues alternativ personin pasardhës të përzgjedhur sipas mekanizmit të parashikuar në këtë rregullore, pa qenë i detyruar të marrë miratim shtesë nga fituesi fillestar ose të mbajë përgjegjësi për mosdorëzimin e dhuratës ndaj tij.

Pjesëmarrës në shorte do të jenë të gjithë konsumatorët që kanë aplikuar në aplikacionin Coca-Cola Play & Win Prizes për t’u bërë pjesë e lojës promovionale Fanta Halloween gjatë periudhës së promovionit: 28 Shtator 2026 – 12 Tetor 2026.

Fituesi do të:

- Njoftohet me email brenda ditës së hedhjes së shorteut. Nëse fituesi nuk përgjigjet në emailin e dërguar brenda 48 orëve pune ose dërgimi i e-mailit dështon, atëherë CCBS-së i lind e drejta të shpallë fitues personin pasardhës.
- Në rast se fituesi nuk përgjigjet në email apo nuk plotëson të gjitha kërkesat si më lart, hap pas hapi pranon se nuk do të ketë asnjë pretendim për dhuratë dhe humbet të drejtën si fitues i këtij Promocioni.

- c) Duhet të dërgojë me email kredencialet e plota si: emër, mbiemër, atësi, numrin e kartës së identitetit të plotësojë një link ku pranon ose nuk pranon që të dhënat personale të tij të jenë të aksesuara nga shoqëria jonë apo të paraqitura në web: www.ccbs.al
- d) Të gjitha të dhënat personale do të përpunohen nga CCBS dhe NV Coca-Cola Services SA,(CCS) vetëm për qëllimin e këtij promovimi, vetëm pas miratimit të kushteve dhe termave të privatësisë për përpunimin e këtyre të dhënave nga ana e aplikuesve në llogarinë e krijuar sipas rregullores përkatëse dhe do të shkatërrohen brenda 14 ditëve nga përfundimi i dorëzimit të dhuratës, sipas ligjit në fuqi, duke mos lejuar humbjen, ndryshimin, përhapjen e pa-autorizuar ose ndërhyrjen të dhënat personale të transmetuara, ruajtura apo përpunuara. Të dhënat personale të mbledhura nga NV Coca-Cola Services SA,(CCS), CCBS dhe Agjensia IUP LABS në kuadër të këtij promovimi sipas kushteve të kësaj rregullore dhe kushteve të privatësisë të pranuar nga fituesit apo pjesëmarrësit në momentin e plotësimit të dhënave të kërkuara në aplikacionin Coca-Cola Play & Win Prizes, do të trajtohen në përputhje me Ligjin “**Nr.124/2024** “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”.
- e) CCBS nuk do të jetë përgjegjëse për asnjë dëm financiar apo jofinanciar (përfshirë dëmin apo fitimin e munguar) që mund të rezultojë si pasojë e pjesëmarrjes në promovimin “**Loja Promocionale Fanta Halloween**” përjashtuar përgjegjësinë ligjore të CCBS.
- f) Të gjithë pjesëmarrësit në lojën promovionale duhet të jenë në dijeni se të dhënat e fituesve në këtë lojë promovionale do të shpallen në faqen zyrtare të lojës promovionale “**Loja Promocionale Fanta Halloween**” dhe bien dakord që të dhënat e tyre të jenë publike në faqen zyrtare pas shpalljes së fituesve deri më datë 31 Tetor 2026, nëse do të japin miratimin e tyre.
- g) Pjesëmarrësit në këtë promovim nuk kanë të drejtë të kërkojnë çmim në sasi më të madhe, apo çmim të ndryshëm nga ai i përcaktuar nga subjekti organizues i fushatës sipas kësaj rregulloreje. Dhuratat e mësipërme nuk janë të konvertueshme në para. Duke marrë pjesë në këtë promovim, pjesëmarrësit detyrohen të respektojnë këtë rregullore.
- h) Promocioni “**Loja Promocionale Fanta Halloween**” mund të ndërpritet në rast forcë madhore dhe/ ose Fatkeqësie Natyrore (rrethana të cila Shoqëria nuk mund t’i kishte parashikuar apo influencuar), përfshirë pamundësinë e CCBS për të vazhduar promovimin “**Loja Promocionale Fanta Halloween**” për arsye që nuk varen nga vullneti i saj. CCBS do të informojë konsumatorët me mjetet e duhura në rast ndërprerje të promovimit “**Loja Promocionale Fanta Halloween**” duke dhënë edhe arsyet e kësaj ndërprerjeje. Në raste të tilla, CCBS nuk do të ketë detyrimin për të dëmshpërblyer pjesëmarrësit për çdo shpenzim lidhur me pjesëmarrjen e tyre në promovim.
- i) Promocioni “**Loja Promocionale Fanta Halloween**” është një promovim që i drejtohet publikut dhe bazohet në nenet 661, 665, 667 paragrafi i parë dhe i tretë, 670 e 671 të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë. Organizimi i **Loja Promocionale Fanta Halloween** bëhet në përputhje me Ligjin 155 /2015 “Për lojërat e fatit në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar me Ligjin nr. 75/2018 datë 25.10.2018 si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 196, datë 15.3.2017 “Përcaktimin e Mënyrave, Formave, Kriteve Dhe Rregullave Për Organizimin E Lojërave Të Fatit Promocionale”. Personat që sipas parashikimeve të kësaj rregullore kanë të drejtë të tërheqin çmimet e vëna në lojë, nëse hasin pengesë në tërheqjen e tyre mund të paraqesin çdo ankesë apo informacion në numrin e tel: +35545606060 ose në adresën e e-mailit: info@cocacola.al.
- j) Fanta është markë e regjistruar e “The Coca-Cola Company”.
- k) Këto rregulla do të botohen pjesërisht në materialet promovionale dhe plotësisht në website (www.coca-cola.com).

Miratoi:

Klesara Fani

Administrator